

2-675

28-23-277:[316.74:2

Xhemail Çupi, PhD¹

**DIPLOMACIA E PROFETIT MUHAMED DHE RELACIONET E
TIJ ME ITHTARËT E LIBRIT**

**ДИПЛОМАТИЈАТА НА ПРОРОКОТ МУХАМЕД И
НЕГОВИТЕ ОДНОСИ СО ЛУЃЕТО ОД КНИГАТА**

**THE DIPLOMACY OF THE PROPHET MUHAMMAD AND HIS
RELATIONS WITH THE PEOPLE OF THE BOOK**

Abstract

It is an undeniable fact that the holy book, the Quran has texts which commands members of islam not to accept Jews and Christians, or unbelievers as friends, (3:28, 5:51), but we should know that those texts relate only to certain situations and extraordinary. Their application is limited to cases of hypocrisy and betrayal between them (Karic & Čančar, 2011, pp. 128-129). In other cases in the Qur'an there is no pronounced hostility between Muslims and members of the heavenly books (Christians and Jews) except verses that invoke in constructive dialogue or debate.

Prophet Muhammad, inspired directly from the Divine came to apply these verses in his life in two stages: during his stay in Makkah and after moving to Medina as a prophet and as a statesman. Migration of Muslims in Abyssinia to Christian King, Special Statute for the monks of the Monastery of Saint Catherine at Mount Sinai, the special Clauses for the Christian people of Najran, the Charter of Medina that included the rights of the Jews of Medina, etc. are arguments that Islam does not stand on the principles of war but emphasizes particularly on cooperation for peace in the world.

Key words: Inter-religious dialogue, the Charter of Medina, the Christians of Najran, Migration to Abyssinia.

¹ Kandidat për PhD në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë,
xhemail.c@hotmail.com

Hyrje

Versetet e para të Kaptinës Rum në librin e Shenjtë, Kur'anin, prekin një moment historik, më konkretisht një luftë që ka ndodhur ndërmjet persianëve, të cilët kanë qenë idhujtarë, dhe bizantinëve, të cilët kanë qenë ithtarë të Librit (Ehli Kitabë), gjegjësisht krishterë. Ndërkaq Kur'ani paralajmëron se persianët që konsideroheshin atëkohë superfuqi, në të ardhmen e afërt do të pësojnë humbje, kurse bizantinët do të fitojnë. Sipas historianit Gibbon, askush nuk kishte mundësi as të ëndërronte së tetë vjet pas paralajmërimit të humbjes së persianëve do të ndodhte që të fitonin bizantinët. Shkaku i zbritjes së këtij ajeti kur'anor është rasti mes Ebu Bekrit dhe kurejshitit Ubejj ibn Halef, i cili iu drejtua Ebu Bekrit duke i thënë se, Muhamedi mendon se brenda disa viteve bizantinët do të dominojnë mbi persianët e, nëse është ashtu, eja të vëmë bast për këtë çështje (në këtë kohë basti akoma nuk ishte ndaluar në Islam). Ndërkohë gjatë kësaj kohe të gjithë politeistët arab mendonin se pasi humbën bizantinët, të cilët ishin krishterë/ehli kitabë, do të humbin edhe muslimanët si Ehli Kitabët/Ithtarët e Librit, sepse edhe muslimanët besonin në një Zot njëjtë si ata. Prandaj Kur'ani u del zot ithtarëve të librit, gjegjësisht bizantinëve. Ebu Bekri e pranoi propozimin e Ubejj ibn Halefit dhe kërkoi: Nëse brenda tre viteve dominojnë bizantinët, t'i do të m'i dhurosh dhjetë deve të reja, e nëse jo, do t'i dhurojë unë. Pas kësaj Ebu Bekri vjen te Profeti Muhamed dhe i tregon për rastin. Profeti Muhamed i tha: Shko dhe rrite numrin e deveve në 100, kurse kohën zgjate deri në 9 vjet, sepse fjala bida' prej gjuhës arabe, ka kuptimin pre 3 deri në 9 vjet. Pas kësaj ndodhi ashtu siç paralajmëroi Zoti dhe humbën persianët, gjegjësisht idhujtarët nga bizantinët krishterë (Nesimi, 2005, p. 68).

Gjatë periudhës së hershme të formimit të bashkësisë islame, Profeti Muhamed nuk i shikonte hebrenjtë dhe të krishterët si individë pas të cilës fshihej Nikeja dhe Kalcedoni, Eklisija (Kisha) ose Tempulli ku janë vendosur pllakat, por ata i shikonte si njerëz të cilëve iu erdhën të Dërguarit nga Zoti. Prandaj ai duke shkuar pas gjurmëve të edukatës kur'anore (2:62, 5:72), Hebrenjtë dhe të Krishterët, asnjëherë nuk i urrente, por iu thoshte “Bëhuni dëshmitarë që ne i jemi dorëzuar Një Zoti”. Alfred Guillam, tanimë i njohur me qëndrimet e tij konfuze ndaj profetit Muhamed, në librin e tij “Tradita e Islamit”, këtë thënie do ta shfrytëzojë si një argument fundamental për tolerancën e gjerë të muslimanëve ndaj hebrenjve dhe të krishterëve (Silajdzic, 2015, p. 24).

Përgjatë historisë, rajoni i gadishullit të Hixhazit, prej jugu në veri dhe prej lindjes në perëndim, ka qenë në kontakt me kultura dhe tradita fetare të ndryshme. Për më tepër kjo zonë është shfaqur si një rajon ku shumë profetë kanë predikuar doktrinën e njëshmërisë (tevhidit) që është i bazuar në unitetin absolut të Allahut për njerëzit. Profetët e tilla si Ibrahim (Abrahami), Musai (Moisiu), Zekerija (Zakariah) dhe Isai (Jezusi) i thirrën njerëzit që të pranojnë Allahun si të vetmin Zot dhe Fuqi Supreme, të mos pranojë asnjë dhe asgjë si homolog të Tij, ta adhurojnë dhe ti shërbejnë vetëm Allahut. E vendosur pothuajse në mes të këtyre mjediseve kulturore dhe fetare, zona e Hixhazit ka qenë e ekspozuar në efektet e traditave të ndryshme politike dhe fetare. Kultura bizantine dhe Krishterimi që përfaqësoheshin kryesisht nga komunitetet e mbështetura bizantine në veri dhe në traditën e sasanidëve dhe zoroastrianëve në verilindje mund të përmenden si traditat më të rëndësishme dhe më me ndikim. Këtyre traditave duhet t'u shtohen edhe komunitetet hebraike që jetonin në vendbanime të ndryshme të rajonit. Sa i takon krishterimit, edhe pse ka pasur disa krishterë në qytetet e mëdha të rajonit si Meka, krishterimi ishte i përhapur më tepër në veri dhe në jug të Hixhazit (Gyndyz, 2015, pp. 97-99). Këtu është me rëndësi të theksojmë se të krishterët e Mekes (me siguri nestorianët), nuk ishin të informuar në lidhje me dogmat e mësimëve zyrtare krishtere. Këtu mund të veçojmë ndonjë prift ose monark, siç ishte Vereka ibn Neufel, i afërt i bashkëshortes së Profetit Muhamed, Hatixhes. Kur Profeti Muhamed u kthye prej shpellës Hira dhe ja rrëfeu ngjarjen Hatixhes ajo e dërgoi te Vereka ibn Neufel, i cili ishte njohës i mirë i Torës dhe Biblës. Pasi e dëgjoi të tërë ngjarjen, ai dëshmoi pejgamberin e tij (Kureshi, 2015, p. 205).

Me këtë konstatohet se nuk ishte e rastësishme përzgjedhja e Profetit të fundit nga Zoti që të jetë pikërisht prej këtij rajoni dhe prej qytetit të Mekes. Në këtë vend ishin gërrshetuar shumë kultura, tradita dhe religjione të ndryshme. Ka edhe hipoteza se Zoti e ka përzgjedhur nga ky vend i shkretët dhe nga mesi i këtyre njerëzve (arabët) që nuk dinin shkrimin dhe leximin dhe kishin humbur vlerat e mirëfillta morale, për ti dhënë botës një mësim se nëse Islami ka arritur të zbut zemrën e tyre të vrazhda do jetë shumë lehtë të udhëzohen popujt e tjerë të botës. Mund të themi lirshëm se kjo hipotezë bie në kundërshtim me atë të lartëshënuarën.

Diplomacia e Muhamedit a.s.

Profeti Muhamed a.s. pas migrimit në qytetin e Jethribit dhe pas formimit të qytet-shtetit të Medines duheshte të njihej ndërkombëtarisht dhe mbi të gjitha deshte që mesazhin e tij tua përcjell të gjitha fuqive të asaj kohe. Para se ta bën këtë ai rregulloi shumë raporte ndërfitare me jomuslimanët brenda gadishullit arabik. Në vitin 628, ai garantoj një statut privilegjesh për murgjërit e Manastirit të Shën Katerinës në Malin Sinai. Ajo përbëhej nga disa klauzola të cilat mbulonin të gjitha aspektet e të drejtave të njeriut, përfshirë këtu tema të tilla si, mbrojtja e të krishterëve, liria e adhurimit dhe lëvizjes, liria për të caktuar gjykatësitë e tyre dhe për të patur dhe mbrojtur pronat e tyre, përjashtimi nga shërbimi ushtarak dhe e drejta e mbrojtjes në kohë lufte. Mësazhi i tij është i ruajtur edhe sot e kësaj dite nëpër arhivat kompetente. Në vijim do paraqesim brendësinë e kësaj letre:

“Ky është një mesazh nga Muhamed ibn Abdullah, si një pakt për ata që mbajnë Krishterimin, pranë dhe larg, ne jemi me ta. Me të vërtetë unë, shërbëtorët, ndihmësit dhe ndjekësit e mi, i mbrojmë ata, sepse të krishterët janë qytetarët e mi, dhe për Allah, unë jam gjithmonë kundër çdo gjëje që i dëshpëron ata. Asnjë lloj detyrimi nuk duhet të ketë mbi ta. As gjykatësit e tyre nuk do të hiqen nga puna dhe as murgjit e tyre nga manastiret e tyre. Asnjë nuk lejohet që të hyjë në shtëpi të tyre, ta dëmtojë atë, apo të marrë ndonjë gjë nga ajo për tek shtëpitë e muslimanëve. Në qoftë se ndonjëri shkel ndonjë nga këta, ai do të shkel paktin e Zotit dhe nuk i bindet profetit të Tij. Me të vërtetë, ata janë aleatët e mi dhe kanë statutin tim të sigurt kundër gjithçkaje që ata urrejnë. Asnjë nuk do t’i detyrojë ata që të udhëtojnë apo t’i obligojë për luftë. Muslimanët duhet të luftojnë për ta. Në qoftë se një femër e krishtere martohet me një musliman, kjo nuk duhet të ndodhë pa aprovimin e saj. Ajo nuk duhet të ndalohet të vizitojë kishën e saj për t’u lutur. Kishat e tyre duhet të respektohen. Atyre nuk duhet t’u ndalohet riparimi i tyre, as shenjtërimi i pakteve të tyre. Asnjë njeri nga ummeti (bashkësia muslimane) nuk duhet të shkelë këtë pakt” (Kruja G. , 2008, p. 116).

Rasti i dytë është letra që ua dërgoi krishterëve të Nexhranit. Profeti Muhamed u shkruan:

“Nexhrani dhe fqinjësia e tij, nga Zoti dhe profeti i Tij Muhamed e kanë të mbrojtur pasurinën e tyre, kishat e tyre dhe gjithçka që kanë në pronësi”.

Nexhrani ishte një qendër tepër e rëndësishme e Krishterizmit në Arabi, është një rajon në veri të Jemenit. Në të ka ekzistuar një

Katedrale madhështore, të cilët krishterët e konsideronin si Kabë të tyre. Pronat e mëdha që i përkisnin Katedrales ishin burim i të ardhurave të mëdha. (Kureshi, 2015, p. 64) Pas dërgimit të letrës nga ana e Muhamedit a.s., një delegacion i të krishterëve të Nexhranit kishte shkuar në Medine dhe atje kishte zhvilluar diskutime të gjata me Profetin Muhamed në xhami. Gjatë kohës së takimit të tyre, të krishterët kërkuan pushim për kryerjen e riteve të tyre fetare, por nuk dinin se ku mund t'i kryenin ato. Profeti Muhamed e kuptoi shqetësimin e tyre dhe i ftoi të kryejnë shërbesën e tyre fetare në xhami, në njërin nga vendet më të shenjta të Islamit (Grup autorësh, 2007, p. 109). Në rastin e ardhjes së këtij delegacioni krishterë, ata kohë pas kohe debatonin me të, bile shpeshherë edhe për ta testuar profetësinë e tij. Ai i dëgjonte me kujdes dhe bisedonte me to me durim, debatonte me to me ditë të tëra duke ua shpjeguar doktrinën e Islamit. Si reagim ndaj kritikave dhe sfidave të tyre ai asnjëherë nuk u përgjigj me dhunë dhe inat, por me durim ua shpjegoi atyre mesazhin kur'anor dhe nuk humbi shpresën dhe vetëbesimin. Në një rast, ai dëgjoi kritikën kundër Islamit dhe kur debati erdhi në pikë që s'ka rrugëdalje, Profeti i thirri përfaqësuesit e Nexhranit në një veprim i quajtur "Mubalah" që domethënë t'i lutesh Zotit që të mallkon gënjeshtarët (Ibn Sa'd, Tabaqat, vol. 1 te autori Gyndyz, 2015, pp. 111-112). Këtë ndodhi e potencon edhe Kur'ani në mënyrë të detajuar (3:61). Delegacioni nuk e pranoi këtë kërkesë nga frika se mallkimi do të binte mbi ta dhe në fund u morën vesh të vendosin një pakt mirëkuptimi mes tyre. (Kureshi, 2015, p. 64)

Një ndër ato letra diplomatike që ka vlerë të potencohet këtu është edhe letra dërguar Çezarit dhe Papës së Vatikanit. Ky I fundit e dëshmoi peygamberinë e tij dhe vërejt: "Pa dyshim, ai është peygamber i vërtetë". Pas kësaj ai drejtoi një kongregacion në katedrale dhe njoftoi njerëzit se ai kishte marrë një letër prej Peygamberit arab Ahmed, i cili i ftonte ata të pranonin besimin e vërtetë tek Allahu, i cili është Një. Ai pastaj dëshmoi se s'ka Zot përveç Allahut dhe se Ahmed i ishte rob dhe i dërguar i Allahut. Njerëzit u zemëruan së tepërmi kur dëgjuan këtë deklaratë të vërtetë dhe e goditën atë kaq shumë, sa që ai vdiq (Historia e Taberit, vol. 3 te autori Kureshi, 2015, p. 117). Letra e Muhamedit a.s. drejtuar Papës së atëhershëm është kjo:

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Paqja qoftë mbi atë që i beson Allahut. Unë besoj se Isa (Jezusi), djali i Mejremes (Marisë) ishte shpirt prej Allahut dhe fjalë e Tij. Allahu e futi atë në Mejremen e devotshme. Unë i besoj Allahut, të gjithë

Librave të Tij dhe Urdhrave të Tij, të cilat Ai m'i shpalli mua dhe të cilat Ai ia ka shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakupit (Zoti qoftë i kënaqur me të gjithë) dhe pasardhësve të tyre. Unë gjithashtu besoj në atë që Allahu i shpalli Musës, Isës dhe pejgamberëve të tjerë (Zoti qoftë i kënaqur me të gjithë). Në fe dhe besim ne nuk bëjmë ndonjë dallim në pranimin e pejgamberëve. Ne jemi musliman (të nënshtruar). Paqja qoftë mbi atë që e pëson udhëzimin. (Historia e Taberit, vol. 3 te autori Kureshi, 2015, p. 117)

Ibn Xheuziu, një hulmtues i mirënjohur dhe kritik i historisë Islame, bëri një zbulim interesant në biografinë e prijësit të muslimanëve, Umerit. Ai kishte zbuluar se Dahu kishte parë një numër të madh pikturash në të gjitha anët e pallatit të Çezarit. Ky i fundit e njoftoi se ata ishin piktura të pejgamberëve të Zotit dhe e pyeti se cila prej tyre ishte piktura e Pejgamberit a.s.. Pasi i vëzhgoi me kujdes pikturat, Dahu tregoi në drejtim të një pikturë dhe tha se ajo ishte piktura e Pejgamberit a.s., Çezari tha: “Vërtet, kjo është piktura e Profetit Muhamed. Ai përsëri e pyeti: Piktura e kujt është ajo, që gjendet në të djathtën e tij? Dahu i tregoi se ai ishte Ebu Bekr Es-Siddiku, shoku i Profetit Muhamed. Pastaj Çezari e pyeti se piktura e kujt ishte ajo që gjendet në të majtë të tij? Dahu i tha se ajo ishte piktura e Umer Farukut shokut të tij të dytë”. Pasi e ndigjoi këtë Çezari tha: “Sipas paralajmërimit të Torës, këta janë dy personat, ndër të cilët religjioni juaj do të arrijë në zenitin e tij.” Është e qartë se disa piktorë me përvojë duhet të kenë shqyrtuar hollësisht përshkrimin e Pejgamberit a.s. dhe të shokëve të tij te Tora dhe te Bibla dhe më pas kanë pikturuar portretet. Ky supozim vërtetohet prej Kur'anit të shenjë (2:146) (Kureshi, 2015, p. 198).

Me këtë dëshmohet se Cezari ka pasur informacione të detajuara për Profetin Muhamedit dhe e gjithë kjo njohuri ndaj tij nuk ka nisur vetëm me letrat dërguar mbretërisë së tij por edhe duke u bazuar në shkrimet dhe parashikimet e vjetra biblike.

Një nga pikat kulminante të raporteve të Muhamedit a.s. me ithtarët e Librit apo Ehlul Kitabët është edhe marrëveshja e quajtur “Karta e Medines”. Kjo kartë konsiderohet kushtetuta e parë në Islam që rregullon të drejtat, obligimet dhe raportet qytetare mes muslimanëve dhe jomuslimanëve dhe historikisht merret në konsideratë edhe nga studiuesit e ligjeve pozitive për të drejtat e njeriut, të drejtat e pakicave, të drejtat e emigrantëve, etj. Më poshtë do paraqesim edhe disa nga nenet e Kartës së Medines:

- *Hebrenjtë me besimtarët (musliman) janë një Ummet (popull).*
- *Hebrenjve u takon feja e tyre, ndërsa besimtarëve (musliman) feja e tyre*

- *Askush nuk mund të bëj krim ndaj aleatëve*
- *Ata që do të strehohen tek hebrenjtë (bitane), do të konsiderohet si vetë hebrenjtë.*

- *Aleatët duhet të ndihmohen në rast rreziku*
- *Aleatët duhet të kenë kujdes nga intrigat reciproke (Nesimi, 2005)*
- *Është detyrë e gjithë muslimanëve të ndihmojnë dhe t'u ofrojnë sjellje miqësore çifutëve, të cilët kanë hyrë në marrëveshje me ta. Asnjë shtrëngim i çfarëdo lloji qoftë nuk duhet ushtruar mbi ta dhe nuk duhet ndihmuar armiqët e tyre kundër tyre.*

- *Çifutët e fisit Benu Auf, Benu En-Nexhxhar, Benu El-Haris, Benu Sa'id, Benu Hashim, Benu Al-Avs, Benu Sa'Laba, Benu Xhafna dhe Benu El-Shataiba që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët të tyre. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej tyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.*

- *Nëse një bashkësi e tretë zhvillon luftë kundër muslimanëve dhe çifutëve, pjesëmarrës në traktat, ata do të duhet të luftojnë bashkërisht. Ata duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin reciprokisht dhe ndërmjet tyre duhet të ekzistojë dashamirësia dhe besueshmëria e ndërsjellë. Çifutët duhet t'i përballojnë shpenzimet e tyre të luftës dhe muslimanët shpenzimet e tyre.*

- *Është detyrë e palëve të kësaj marrëveshjeje të sillen me njëri-tjetrin sinqerisht dhe ti'a dëshirojnë të mirën njëri-tjetrit. Asnjëri nuk duhet të bëjë tjetrin objekt shtypjeje dhe padrejtësie dhe i shtypuri duhet të ndihmohet.*

- *Çifutët duhet t'i ndajnë shpenzimet së bashku me muslimanët për aq kohë sa ata luftojnë bashkërisht.*

- *Nëse Jethribi (Medina) do të pushtohet, muslimanët dhe çifutët bashkërisht duhet ti kundërvihen me një mbrojtje të bashkuar.*

- *Nëse muslimanët bëjnë traktat paqeje me ndokënd, çifutet duhet ta respektojnë atë. Edhe nëse çifutët bëjnë paqe me ndokënd, muslimanët janë të obliguar të ofrojnë bashkëpunim të ngjashëm me çifutët. Por në rast të ndonjë lufte fetare të njëres palë, nuk do të jetë përgjegjësi e palës tjetër të bashkëveprojë në të.*

- *Në rast të pushtimit të Jethribit (Medines) secila palë duhet të mbrojë pjesën që është përpara saj. (Kureshi, 2015, pp. 51-54)*

Si rezultat i kësaj marrëveshjeje, gjatë periudhës së pejgamberisë së Muhamedit në Medine disa çifutë u paraqitën te Profeti Muhamed, që ai të zgjidhën dhe të gjykon në një debat dhe mospajtim mes tyre dhe

një rast tjetër mes tyre dhe disa muslimanëve. Në rastin e parë, duke u bazuar në rastet gjyqësore mes çifutëve ai gjykoi në bazë të ligjeve të tyre gjyqësore. Në rastin e dytë ai gjykoi në favor të çifutëve pasi dëgjoi rastin nga të dy palët, por muslimanët që në fakt ishin hipokritë ishin të mërzytur nga ai gjykim. Kjo ngjarje potencohet edhe në Librin e Shenjtë, Kur'anin (4:65) (Gyndyz, 2015, p. 113).

Profeti u mundua të lidhën raporte të mira më çdo njeri pasi shqetësimi i tij kryesor ishte të predikojë të vërtetën dhe të zgjedh mënyrën më të duhur se si ti shpëtoj njerëzit. Ai ishte i vetëdijshëm në dallimet e tij me jo muslimanët, por kjo nuk e pengoi që ai të formon marrëdhënie të mira me ato që ishin të afërt me muslimanët. Për shembull, ai këshilloi disa muslimanë që të migrojnë në tokën e Abisinisë, në shtetin e udhëheqësit krishter Nexhashiu, duke thënë se: “Ai është vendi i të drejtës dhe të vërtetës”. Bazuar në datat historike migrimi në Abisini erdhi në shprehje mes viteve 614 dhe 615, në vitin e pestë të Profetësisë së tij. Në migrimin e parë morën pjesë vetëm 15 muslimanë. Pas një viti ata migruan për herë të dytë. Këtë herë numri i tyre arriti në 100. Është interesante se Profeti Muhamed kur u ballafaqua me presionin dhe dhunën e përzgjedhi pikërisht Abisininë dhe jo Sirinë, Jemenin apo ndonjë regjion tjetër për të emigruar. Pa pikë dyshimi mund të konkludojmë se bindja pozitive e Profetit Muhamed ndaj administratës politike të Abisinisë luajti një rol në zgjedhjen e tij. Ai tha:

“Nëse dëshironi dhe mundni, kërkonte strehim në Abisini. Atje ka një udhëheqës i cili asnjëherë nuk ka shtypur askënd. Është një vend i të drejtës dhe të vërtetës. Jetoni dhe rini atje derisa Allahu tua lehtëson gjendjen”.

Në fakt, muslimanët që emigruan na Abisini u morën në mbrojtje të shtetit dhe atyre ju garantua liria. Si përgjigje ndaj kësaj dashamirësie, muslimanët e migruar atje dhanë një kontribut pozitiv në strukturën sociale dhe politike duke kontribuar në shoqëri (Gyndyz, 2015, pp. 104-105).

Konkludim

Kanë kaluar shumë shekuj nga koha e Profetëve të fundit, por ithtarët e dy feve më të mëdhaja botërore, asaj krishtere dhe muslimane, duke u larguar nga doktrinat e tyre fetare që promovojnë unitet dhe paqe në botë shpesh herë janë konfrontuar mes veti.

Në një numër të vitin 1990, revista “The Economist” publikoi një dialog të paramenduar ndërmjet një lideri fetar të krishterë dhe

musliman. Ky i fundit thotë: “Më brengos ajo që shumë njerëz besojnë se në një periudhë të ardhshme të historisë do të ndodhë një luftë ndërmjet jush dhe nesh, është e vërtetë se jetojmë një bërnyl larg njëritjetrit dhe se bërnylat tanë janë takuar në mënyrë të dhimbshme në shumë raste në të kaluarën. Por më lejoni që, pothuajse 2.000 vite nga lindja e Jezusit dhe 1.400 vite nga lindja e Muhamedit, të filloj me pyetjen, se a është e domosdoshme të ndodhë edhe një herë një gjë e atillë?” (Karlsson, 2010, pp. 372-373)

Si rrjedhojë e të lartshënuarës, ky vit dhe ky muaj (dhjetor 2015), pas shumë viteve ka bashkuar përkujtimin e ditëlindjes së dy njerëzve më të shquar të historisë së njerëzimit, dy të dërguarve nga Zoti i gjithësisë me Libra hyjnorë: Jezusit (Profetit Isa) dhe Profeti Muhamed, paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi ta. Pa u ndalur fare te saktësia e detajeve të kohës së lindjes së Jezusit / Profetit Isa dhe ardhjes së tij në këtë botë, datëlindja e dy vëllezërve (të trungut profetik) më të vogël me moshë, por më të mëdhenj me ithtarë, pas shumë viteve takohen shumë afër njëri me tjetrin. Ky bashkim i ditëlindjeve të tyre le të jetë një mësim për ithtarët e dy religjioneve që përbëjnë dy të tretat e popullsisë botërore që nëse pretendojnë se ndjekim porosinë e Jezusit dhe Profetit Muhamed, kur të ballafaqohen mes veti apo të bashkëjetojnë, nuk duhet të kenë alternativë luftën, konfrontimin, debatin destruktiv, kokëfortësinë, por vetëm paqen, mirëkuptimin, solidaritetin, debatin konstruktiv, dialogun e mirëfilltë ndërftuar dhe pse jo, edhe bashkëjetesën e mirëfilltë.

Resume

Many centuries have passed from the time of the last Prophets and divine revelations, but followers of the two bigger religions of the world, Christian and Muslim, moving away from their religious doctrines that promote unity and peace in the world, often are confronted with each other in negative way.

Based on what we said, this year and this month (December 2015), after many years, has joined the commemoration of the birthday of both the most outstanding “Men” in the history of mankind, two messengers from the Lord of the Universe with Divine Books: Jesus (Prophet Isa) and the Prophet Muhammad, peace and blessings be upon them. Without stopping at the accuracy of details on the time of the birth of Jesus and his coming into this world, the birthday of two

brothers smaller with age (of the Prophetic trunk), but the bulk of followers, after many years they meet very close to each other.

This closeness of their birthdays let it be a lesson for the followers of both religions that make up two-thirds of the world population that if they claim to follow the orders of Jesus and the Prophet Muhammad, when they will face each other or will live together, there should not be alternative: war, confrontation, destructive debate, stubbornness; but only peace, understanding, solidarity and constructive debate, genuine interfaith dialogue and why not, even the genuine coexistence.

Bibliografia

Grup autorësh. (2007). *Simpoziumi Ndërkombëtar: Profeti Muhamed – Mëshira dhe dashuria universal*. Tiranë: Botimet KMSH.

Gyndyz, S. (2015). *Living together - An Islamic Perspective on Coexistence of Diversity*. Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos A.

Kariq, E., & Çançar, N. (2011). *Fundamentalizmi islam, çështë ky?* Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos A.

Karlsson, I. (2010). *Besimi, terrori dhe toleranca*. Shkup: Shkupi.

Kruja, G. (2008). *Shqiptarët përballë sfidave të mirkuptimit ndërjetar*. Tiranë: Prizmi.

Kureshi, S. A. (2015). *Letrat e Muhamedit a.s.* Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos A.

Nesimi, Q. (2005). *Dialogu obligim hyjnor*. Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos A.

Silajdzic, A. (2015). *Islami në zbulimin e Evropës krishtere*. Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos A.